

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

Për të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës së Partisë LDLNj  
për zgjedhjet kuvendore të 28 Qershorit 2009

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Tiranë

Të nderuar zoterinj,

Ne kemi audituar të ardhurat dhe shpenzimet e Partisë Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, për fushatën zgjedhore të 28 Qershorit 2009, sipas informatës bashkëngjitur. Kjo deklarata financiare është përgjegjësi e Drejtimit të Partisë LDLNj. Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këtë deklarata financiare bazuar në auditimin e kryer.

Në kryem auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojmë e kryejmë auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme se kjo pasqyrë nuk përmban anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin mbi bazën e gjithëpërfshirjes së fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet e dhëna në pasqyrën financiare. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve për një qellim specifik. Ne çojmë se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin e pavarur.

Bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme shpreh opinionin se deklarata për të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës së Partisë LDLNj nuk jep një pamje reale për gjendjen e vërtetë të të ardhurave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Shqipërisë të dalë nga zgjedhjet e 28 Qershorit 2009.

Mihal ZIU  
Ekspert Kontabël

Tiranë, 2 Nentor 2009

**Shënime për deklaratimet financiare të  
Partisë Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut  
për fushatën e zgjedhjeve të 28 Qershorit 2009.**

Fushata për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë ka filluar me 25 Maj 2009 dhe ka mbaruar më 28 Qershor 2009. Periudha financiare për këtë veprimtari politike të Partisë Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut nuk mund të përcaktohet prerazi, pasi kjo Parti nuk ka struktura të plotësuara për administrimin financiar dhe për pasojë të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore nuk janë dokumentuar dhe kontabiliteti nuk ekziston. Deklarata e dhënë nga Drejtimi i Partisë si "Informacion për shpenzimet financiare të fushatës zgjedhore parlamentare të 28 Qershorit 2009" nuk përmban elementët e një deklarate financiare. Në këto kushte nuk ekziston mundësia për një auditim të mirëfilltë të fondeve të grumbulluara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore kuvendore të 28 Qershorit 2009. Me gjithë këtë, nga kontakti dhe shpjegimet e dhëna nga kryetari dhe financierja e Partisë, si dhe nga investigimet e verifikimet e bëra rezulton se :

1. Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut nuk ka përfituar fonde nga buxheti shtetit.
2. Partia LDLNj nuk ka çelur llogari bankare të posaçme për fushatën zgjedhore dhe nuk ka transaksione bankare për këtë qëllim.
3. Arka e Partisë LDLNj nuk ka funksionuar dhe departamenti i financës nuk disponon dokumente për arkëtimin e donacioneve dhe për pagesën e shpenzimeve të kryera gjatë fushatës zgjedhore.
4. Shpenzimet e fushatës janë mbuluar financiarisht nga kandidatët për deputet që kryesojnë listat e qarqeve, si më poshtë :
  - Zoti Ligoraq Karamelo për qarkun e Korçës
  - Zoti Hazbi Dervishi për qarkun e Tiranës
  - Zoti Edmond Milori për qarkun e Vlorës
  - Zoti Ramazan Tamizi për qarkun e Durrësit
  - Zoti Kozma Jano për qarkun e Fierit
  - Zoti Rigers Barka për qarkun e Elbasani
  - Zoti Llambi Barka për qarkun e Gjirokastrës
  - Për qarqet e tjera aktiviteti ka qënë minimal dhe LDLNj nuk deklaroi asnjë shpenzim financiar.

Nga verifikimi rezulton se Partia Lëvizja për të Drejtatat dhe Liritë e Njeriut nuk ka mbajtur regjistrin e posaçëm për identifikimin e donatorëve dhe të shumave të dhurura prej tyre.

Gjithashtu asnjë nga donatorët e sipërshënuar nuk ka nënshkruar deklaratën e mospasjes konflikt interesi sipas formatit të kërkuar nga KQZ. Partia LDLNj nuk disponon asnjë dokument justifikues për shpenzimet e kryera CASH nga vetë kandidatët për deputet.

Në këto kushte, në cilësinë time si ekspert kontabël, nuk formova bindjen dhe mundësinë e nevojshme për të certifikuar fondet e përfituara e të shpenzuara nga Lëvizja për të Drejtatat dhe Liritë e Njeriut për fushatën e zgjedhjeve të 28 Qershorit 2009, por me siguri të arsyeshme shpreh opinionin se deklarata financiare e LDLNj-së nuk jep një pamje reale për gjendjen e vërtetë të fondeve të përfituara dhe shpenzimeve të kryera gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Shqipërisë të dale nga zgjedhjet e 28 Qershorit 2009.

Mihal ZIU  
Ekspert Kontabël

Tiranë, 2 Nëntor 2009